



INSTITUTI KOSOVAR PËR HULUMTIM DHE ZHVILLIM TË POLITIKAVE

ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË KOSOVË 2010: Vështrim i përgjithshëm dhe trendët

Ky projekt është mbështetur nga Friedrich Ebert Stiftung - FES



Prishtinë, prill 2011

Vërejtje: Mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk paraqesin domosdo mendimet e Friedrich Ebert Stiftung - FES

Përgatitur nga: Burim Ejupi dhe Shkamb Qavdarbasha

E drejta autoriale © 2011 e KIPRED-it. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit. Ju lutem kontaktoni info@kipred.net apo +381 38 227 778.

Botuar nga



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave

Rr. Rexhep Mala, nr. 5A

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni dhe faksi: +381 38 227 778

www.kipred.net

PËRMBAJTJA

I. Hyrje.....	5
II. Legjislacioni	6
III. Procesi Zgjedhor	
Partitë Politike dhe Përgatitjet.....	7
Para zgjedhjeve.....	9
Fushata zgjedhore	10
Dita e zgjedhjeve.....	11
Ankesat dhe parashtrirat	13
Rizgjedhjet.....	14
Rinumërimi	15
IV. Trendet e Votimit për zgjedhjet parlamentare të 2010.....	17
Pjesëmarrja e elektoratit	17
Votat me kusht dhe votat e pavlefshme	18
Partitë politike.....	20
V. Gjinia.....	24
VI. Përfundime dhe Rekomandime	25

LISTA E SHKURTESAVE:

AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (parti politike)

ADK – Alternativa Demokratike e Kosovës (parti politike)

AKR – Aleanca Kosova e Re (parti politike)

BIRN – Rrjeti ballkanik për gazetari hulumtuese

KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

OSHC – Organizatat e Shoqërisë Civile

DV – Demokracia në Veprim

KZAP – Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (tani PZAP)

PZAP – Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (ish-KZAP)

ENEMO – Rrjeti evropian i organizatave të monitorimit të zgjedhjeve

BE – Bashkimi Evropian

FER – Fryma e Re (parti politike)

KDTP – Partia Demokratike Turke e Kosovës (Kosova Demokratik Turk Partesi) (parti politike)

LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës (parti politike)

LEK – Lidhja e Egjiptianëve të Kosovës (parti politike)

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

PKD – Partia Demokratike e Kosovës (parti politike)

PSHDK – Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës (parti politike)

PTK – Posta dhe Telekomuni i Kosovës

SLS – Partia Liberale Serbe (parti politike)

ShBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës

VV - Vetëvendosje

I HYRJE

Zgjedhjet e para parlamentare në Kosovën e pavarur, u shënuan me një varg parregullsisht dhe mashtrimesh. Megjithatë, edhe me mashtrime të shumta, këto zgjedhje dëshmuar se shteti mund t'i qëndrojë një krize politike, ndonëse nën trysni të mëdha.

Në shtator të vitit 2010, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës vendosi se presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, kishte shkelur Kushtetutën e Kosovës duke mbajtur njëkohësisht postin e presidentit të vendit dhe atë të liderit të Lidhjes Demokratike të Kosovës¹. Përkundër faktit që kjo u përdor si arsytim për krizën institucionale që pasoi, problemi i vërtetë qëndronte tek marrëveshja e koalicionit qeveritar² për të mbajtur presidentin në atë pozitë. Ky vendim është marrë pavarësisht dijenisë së tyre për mos kushtetutshmërinë e atij veprimi pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008.³

Pas vendimit, presidenti dha dorëheqjen nga posti i tij për të mbajtur postin e liderit të LDK-së. Z. Jakup Krasniqi, kryetari i Kuvendit të Kosovës, mori detyrat dhe përgjegjësitë e zyrës si ushtrues detyre i presidentit, siç parashihet në kushtetutë. Vendimi i parë i z. Krasniqi, në pajtim të plotë me partitë e tjera politike, ishte caktimi i një date për zgjedhje të parakohshme, gjegjësisht 13 shkurt 2011.

Dorëheqja e presidentit Sejdiu solli ndryshime të sjelljes së partisë së tij brenda koalicionit. LDK-ja ndërpreu mbështetjen për privatizimin e Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK), një strategji që ata e kishin hartuar së bashku me PDK-në në kohën kur ishin anëtarë të koalicionit. LDK-ja propozoi që ratifikimi i strategjisë të privatizimit të PTK-së të hiqej nga agjenda e qeverisë, por plani u miratua pas një presioni të paligjshëm nga ana e PDK-së në Kuvend. Si rezultat i këtij procesi, më 16 tetor 2010, LDK-ja gjeti një arsytim për të dalë nga koalicioni qeveritar⁴, duke lënë kështu shtetin me një qeveri pakicë dhe në një ngërç politik.

Pas këtyre ngjarjeve, Aleanca Kosova e Re (AKR) parashitroi kërkesën për votën e mosbesimit ndaj qeverisë të udhëhequr nga PDK-ja. Propozimi ishte miratuar më 2 nëntor 2010 nga shumica dërmuese e votuesve të pranishëm në Kuvend, përfshirë deputetët e PDK-së.⁵ Në përputhje me ligjin, Kuvendi i Kosovës ndërpreu mbledhjet dhe kryetari i Kuvendit ishte i detyruar të caktonte zgjedhje të reja së paku 30 ditë dhe më së largu 45 ditë nga shpërbërja e Kuvendit. Ndërsa zgjedhjet u caktuan brenda afatit ligjor prej 45 ditësh, siç kërkohet me ligj, qeveria pakicë ka pasur mundësinë të qëndrojë si qeveri teknike. Kjo do ti

¹ Rasti nr. KI 47/10, Gjykata Kushtetuese e Kosovës. 29 shtator 2010. http://www.gjk-ks.org/repository/docs/ki_47_10_eng_2.pdf

² Koalicioni qeverisës gjatë viteve 2007-2010 mes Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe LDK.

³ Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave, Shkaqet e vërteta të krizës institucionale të Kosovës (Policy Brief 2010/6), 2010. http://kipred.net/web/upload/the_actual_causes_of_kosovo.pdf

⁴ Për një shpjegim më të hollësishëm kontaktoni: Institutin Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave, Shkaqet e vërteta të krizës institucionale të Kosovës (Policy Brief 2010/6), 2010. http://kipred.net/web/upload/the_actual_causes_of_kosovo.pdf

⁵ Nga seanca plenare e Kuvendit të Kosovës, 2 nëntor 2010. <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,128,3501>

jepte mjaft kohë për të votuar buxhetin që atëherë vetëm ishte përgatitur, si dhe të udhëhiqte shtetin deri në afatin e zgjedhjeve të hershme të parapara të mbahen më 13 shkurt 2011. Nësë një vendim i tillë nuk do të ishte marrë, partitë politike, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dhe shoqëria civile do të kishin më shumë kohë për të bërë përgatitjet adekuatë për zgjedhje.

Gjatë kohës së shkurtë para zgjedhjeve, partia e dytë më e madhe në vend, LDK-ja, zgjodhi të distancohet nga partia në pushtet sa më shumë që të ishte e mundur. Kjo u bë me qëllim që sa më shumë mangësi të koalicionit të mëparshëm të binin mbi partinë kryesore, PDK-në.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe ekspertët e pavarur të zgjedhjeve ishin të brengosur rreth parregullsive të mundshme në bastionet e votuesve të disa partive.⁶ Përpos parregullsive të nxitura nga publiku, problemet rreth zgjedhjeve mund t'i atribuohen kohës së shkurtë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) kishte për të përgatitur të tërë procesin. Faktikisht, udhëheqja e KQZ-së, Valdete Daka, ka thënë se KQZ-ja nuk garanton proces cilësor të zgjedhjeve të 12 dhjetorit 2010.⁷

II LEGJISLACIONI

Pas ratifikimit të planit të Ahtisarit nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2007, brenda 120 ditëve pas shpalljes së pavarësisë, Kuvendi ishte përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të nevojshëm që ishte paraparë përmes këtij plani.⁸ Në mesin e ligjeve të para që duhej të zbatoheshin menjëherë ishte edhe ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale. Gjatë kësaj periudhe 120 ditore, të gjitha ligjet, që njiheshin edhe si ligjet e pakos së Ahtisarit, u miratuan me shpejtësi, pa debat të duhur në Kuvend apo me qytetarë.

Gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2009, u vërejtën disa mangësi të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale. Një nga problemet e vazhdueshme që dolën gjatë zgjedhjeve të 15 nëntorit 2009 ishte përkufizimi i paqartë i përgjegjësive të KQZ-së dhe të Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP). Në maj të 2010 u themelua një ekip për të rregulluar mangësitë e Ligjit për zgjedhje, i cili përfshinte anëtarë nga Kuvendi i Kosovës dhe shoqëria civile, me ndihmë nga aktorët ndërkombëtarë në Kosovë. Puna e këtij grupi ishte minuar për shkak të çështjeve teknike, siç ishte ajo se kush duhej të udhëhiqte grupin, partia në pushtet apo opozita. Gjithashtu, dy anëtarë nga shoqëria civile ishin pjesë e panelit për reformimin e Ligjit për zgjedhje. Një nga anëtarët i përkiste koalicionit të OJQ-ve Demokracia në Veprim, ndërsa tjetra ishte përfaqësuese nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore me njohuri rreth zgjedhjeve. Puna nuk rifilloi deri në qershor, kur udhëheqësja e KQZ-së mori rolin e drejtimit të grupit.

⁶ Intervistat e shumta nga KIPRED-i të bëra me anëtarët e shoqërisë civile nëpër gazeta dhe televizione vendore - 1 deri 10 dhjetor 2010.

⁷ Deklarata e dhënë nga kryesuesja e KQZ-së, Valdete Daka, siç është raportuar në gazetat Koha ditore, Zëri dhe Express më 18 tetor 2010.

⁸ Plani gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës, shtojca XII, Neni 1.

Një nga çështjet e diskutuara ishte pragu zgjedhor ku diskutimet u sollën rreth asaj se a duhej mbajtur pragu në 5% apo 3%. Megjithatë, partitë e minoriteteve gëzonin një nivel të pragut prej 1% dhe kishte konsensus të plotë për të mos ndryshuar këtë kërkesë. Shqyrtimi i kësaj çështjeje ishte kërkuar nga partitë e vogla që nuk arritën të hynin në Kuvend dhe ishte përkrahur nga përfaqësuesit e shoqërisë civile. Ky propozim nuk kaloi, dhe ragu për të hyrë në Kuvend mbeti në 5%.

Shqyrtimi përfundimtar përfshiu disa ndryshime në Ligjin e Kosovës për zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale. Një nga ndryshimet madhore përfshiu riemërimin e Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP) në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP). PZAP, sipas ligjit të ndryshuar, do të pranojë ankesa lidhur me zgjedhjet brenda 24 orëve pas përfundimit të procesit zgjedhor dhe duhet të marrë vendim mbi ankesat brenda 72 orëve. Një ndryshim tjetër, që gëzoi përkrahje unanime nga partitë politike, ishte ngritja e numrit të kandidatëve për të cilët mund të votohet në pesë kandidatë për parti politike.

III PROCESI ZGJEDHOR

PARTITË POLITIKE DHE PËRGATITJET

Për zgjedhjet e vitit 2010, KQZ-ja regjistroi gjithsej 55 subjekte politike, 23 prej të cilave u takonin shqiptarëve, 11 serbëve dhe pjesa tjetër grupeve të ndryshme të pakicave.⁹ Nga 55 subjektet e regjistruara, 26 parti politike dhe 3 iniciative të qytetarëve u certifikuan për zgjedhje.¹⁰

Për herë të parë, në vitin 2010, dy parti politike nga pakicat turke në Kosovë morën pjesë në zgjedhjet e përgjithshme. Në këto zgjedhje u paraqit edhe një entitet i ri politik që i përkiste pakicës turke, që shënoi herën e parë të krijimit të konkurrencës së brendshme politike në këtë komunitet. KDTP mbeti partia më e madhe e këtij komunitetit, duke fituar shumicën e vendeve në Kuvend që ishin në dispozicion për komunitetin turk.

Komuniteti egjiptas gjithashtu mori pjesë në zgjedhjet e përgjithshme, me një listë qytetare të quajtur Lidhja e Egjiptianëve të Kosovës (LEK). Kjo ishte hera e parë që ky komunitet kishte më shumë se një subjekt politik që garonte për kuvend, pavarësisht se LEK nuk ishte i suksesshëm në këto zgjedhje.

Partia Liberale Serbe (SLS) hyri në zgjedhje si pjesë e koalicionit të mëparshëm qeverisës dhe si fituese e zgjedhjeve lokale në komunat me shumicë serbe. Kjo parti karakterizohet me thirrjet e tyre ndaj komunitetit serb për t'u integruar në shoqërinë kosovare. Në këto zgjedhje, komuniteti serb u përfaqësua nga gjithsej nëntë subjekte politike, dy më shumë se komuniteti shumicë i shqiptarëve.

⁹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Zyra e regjistrimit dhe certifikimit të partive politike, lista e kandidatëve <http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/en/rrethkqz/lk.html>

¹⁰ Po aty.

Për herë të parë gjatë zgjedhjeve të dhjetorit 2010, morri pjesë një parti politike përfaqësuese e komunitetit malazez në Kosovë. Ky është komuniteti i vetëm në Kosovë që nuk ka kuotë të pakicës dhe që nuk njihet zyrtarisht si komunitet i Kosovës¹¹.

Një karakteristikë tjetër e këtyre zgjedhjeve ishte se Lëvizja Vetëvendosje vendosi të regjistrohet si subjekt politik dhe të garojë për vende në kuvend. Kjo lëvizje është njohur si opozitë e fortë e sferës politike të Kosovës, demonstruar përmes protestave. "Vetëvendosje" shpejt u përhap nëpër Kosovë, duke fituar shumë mbështetje. Ky është një fakt interesant, posaçërisht duke pasur parasysh mungesën e tyre në mediumet tradicionale të reklamimit.

Një parti tjetër e re që u shfaq gjatë zgjedhjeve të fundit ishte Fryma e Re (FER). Kjo parti, e themeluar nga dy liderë të shoqërisë civile, është e përqendruar në sundimin e ligjit dhe në profesionalizmin e anëtarëve të saj si vlerat kyçe të partisë. Pas zgjedhjeve, kjo parti iu bashkua Vetëvendosjes.

Meqë pragu për të hyrë në kuvend ishte 5% e votave të përgjithshme të hedhura për partitë shqiptare, shumica e partive të vogla hynë në koalicione me subjektet më të mëdha. Kjo t'u rriste mundësitë atyre për të hyrë në Kuvend, si parti qeverisëse apo si opozitë.

Një nga marrëveshjet më të mëdha për sa i përket koalicioneve parazgjedhore ishte ajo e Aleancës Kosova e Re (AKR) e përbërë prej shtatë partive politike që nuk diskriminojnë për nga ideologjitë e partive, dhe përfshiu socialdemokratët, partitë e gjelbra dhe partitë e djathta konservative. Ky koalicion qartazi u formua për të hyrë në zgjedhje në formë më të fortë për të fituar një numër më të madh të votave. Kjo strategji ishte shumë e rëndësishme për këto parti relativisht të vogla për shkak të kohëzgjatjes së shkurtë të fushatës zgjedhore dhe epërsisë teknike dhe financiare të partive më të mëdha.

AAK garoi në zgjedhje në koalicion me një fraksion që braktisi LDK-në dhe që udhëhiqej nga Ukë Rugova, i biri i presidentit të ndjerë Ibrahim Rugova. AAK gjithashtu përfshiu një numër të madh të deputetëve të pavarur të kuvendit në radhët e saja.

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) hyri në zgjedhjet parlamentare të 2010 me një udhëheqësi të re të zgjedhur vetëm katër ditë para afatit të certifikimit të partive nga KQZ-ja. Dy të tretat e anëtarëve të partisë ishin gjithashtu të ri, ndërsa lista e deputetëve të Kuvendit kryesisht i takonte strukturës së vjetër të LDK-së.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) mbajti kongresin e partisë së saj dhe zgjedhjet e brendshme pro-forma, duke pas parasysh se nuk zgjedhje në degët e partisë dhe udhëheqësia e lartë e partisë u rizgjodh pa konkurrencë. Ndryshe prej vitit 2007, kur partia hyri në zgjedhje në një koalicion prej shtatë partive, në vitin 2010 kishte vetëm Aleancën

¹¹ Për listën e plotë të komuniteteve të njohura në Kosovë, referojuni Ligjit nr. 03/L-047 "për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Kosovë" që gjendet në http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L047_en.pdf. Dispozita të tjera mund të gjenden në Kushtetutën e Kosovës.

Demokratike të Kosovës (ADK) dhe Partinë Shqiptare Demokristiane të Kosovës (PSHDK) si aleatë.

Një numër i caktuar i partive politike tani më të themeluara mbajtën kongrese apo zgjedhje të brendshme partiake për të respektuar ligjin e Kosovës që parasheh që partitë politike të mbajnë zgjedhje të brendshme më së largu 36 muaj para certifikimit. Në zgjedhjet e mëparshme, disa parti politike u certifikuan edhe pse nuk kishin mbajtur zgjedhje të brendshme.

PARA ZGJEDHJEVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u ballafaqua me një presion të konsiderueshëm gjatë vitit 2010, pjesërisht për shkak të faktorëve jashtë kontrollit të tyre. Në qershor, presidenti i atëhershëm i Kosovës Fatmir Sejdiu, sipas Kushtetutës së Kosovës, zgjodhi një kryesuese të re të KQZ-zë, Valdete Daka, gjykatëse dhe anëtare e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Kryesuesja e re u përzgjodh pasi që ish-kryesuesja, Nesrin Lushta, dha dorëheqje për shkak të akuzave se nuk ka qëndruar në seancat vendimmarrëse. Daka kishte pak kohë që të njoftohej me punën, për shkak se shumë shpejt pas zgjedhjes së saj në postin e KQZ-së, ajo u përball me një vazhde ndryshimesh dhe zhvillimesh të shpejta.

Në vitin 2010, KQZ-ja është dashur është dashur të implementojë ndryshimet e bëra në ligjin elektoral. Megjithëse këto ndryshime nuk ishin substanciale, një kombinim i një varg ngjarjesh, si caktimi i kryesueses së re dhe rizgjedhjet në Rahovec, e kanë vënë këtë institucion nëpër një test të rëndë të qëndrueshmërisë.

Sfida e parë e KQZ-së ishte organizimi i rizgjedhjeve në një nga komunat e Kosovës, gjegjësisht atë të Rahovecit, pas dorëheqjes të kryetarit të asaj komune. Dorëheqja ishte e mjegulluar me një varg parregullsish që përfshinin figura të larta të qeverisë dhe gjatë ditës së zgjedhjeve kishte raportime të problemeve. Pas procesit të numërimit të votave, KQZ-ja njoftoi se dy parti, PDK-ja dhe LDK, kishin për të shkuar në balotazh. Megjithatë, partia e tretë në listë, AAK-ja, paraqiti një ankesë. Pas rinumërimit të votave, doli se AAK-ja duhej të shkonte në balotazh me LDK-në dhe fitoi balotazhin komunal. Ky proces tregoi se KQZ-ja veçse ishte duke pasur probleme me administrimin e detyrave të parapara në kuadër të mandatit. KQZ-ja u ngarkua më shumë kur data e zgjedhjeve të përgjithshme ndryshoi dy herë brenda një kohe shumë të shkurtë. Kjo i shtyu ata t'i përshpejtonin përgatitjet duke rrezikuar kështu cilësinë dhe sigurinë e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2010.

Problemi nuk ishte vetëm me KQZ-në. Në zgjedhjet e vitit 2010 në Rahovec, Demokracia në veprim (DV) shërbeu si monitorues i zgjedhjeve. Ky koalicion i OJQ-ve, i formuar në vitin 2007 me qëllimin e monitorimit të zgjedhjeve, bëri të njëjtin gabim me procesin e numërimit të votave në Rahovec. Kjo disi e pengoi reputacionin e DV-së mbi aftësinë e tyre për t'u përballur me procesin e monitorimit të zgjedhjeve në mbarë vendin pavarësisht suksesit të tyre në kryerjen e kësaj detyre në vitin 2007.

Për zgjedhjet e dhjetorit të vitit 2010, DV-ja akreditoi diku rreth 5000 monitorues të zgjedhjeve që do të vepronin në tërë Kosovën. DV-ja kishte mbështetje të plotë financiare dhe publike nga komuniteti ndërkombëtar, gjë shpresat e qytetarëve për profesionalizëm nga kjo organizatë. Përveç këtij numri ishin edhe 120 pjesëmarrës nga Rrjeti Evropian i Organizatave për Monitorimin e Zgjedhjeve (ENEMO), anëtarë nga ambasadat eminente në Kosovë përfshirë ambasadorë, anëtarë të partive politike dhe organizata të paasociuara të shoqërisë civile, siç është Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN). Megjithatë, organizatat madhore ndërkombëtare që punojnë drejtpërdrejtë me procesin zgjedhor, siç është Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) nuk mori pjesë për shkak se disa anëtarë drejtues të saj nuk e njohin pavarësinë e vendit. Niveli i ndikimit që kjo kishte në zgjedhjet është i diskutueshëm, megjithatë prania e një numri të madh të vëzhguesve të huaj me siguri do të kishte siguruar më mirë pavarësinë e zgjedhjeve.

Përgatitjet e përgjithshme për zgjedhjet e dhjetorit 2010 ishin shumë të ngarkuara nga një numër faktorësh dhe rrethanash. Jo pak prej tyre kanë qenë të ndërlidhura me ndryshimin e dyhershëm të datave brenda një periudhe të shkurtë. KQZ-ja u përball me një numër sfidash që i rënduan kapacitetet e saja. Ndër këto sfida ishte edhe buxheti prej 2,5 euro për një votues të regjistruar të alokuar për zgjedhjet e përgjithshme¹². Kjo është pasqyruar edhe në aftësinë e shoqërisë civile të Kosovës për të qenë në hap me zhvillimet, e pasqyruar në performancën e tyre gjatë monitorimit të zgjedhjeve në Rahovec dhe në mbarë vendin. Megjithatë, gjatë ditës së zgjedhjeve, minimumi i kërkesave juridike për mbajtjen e zgjedhjeve u përmbush.

FUSHATA ZGJEDHORE

Partitë politike në Kosovë u përballën me një konkurrencë të ngjeshur meqë fushata zgjedhore ishte shumë e shkurtë, vetëm 10 ditë. Gjatë këtyre 10 ditëve partitë më të mëdha kishin një avantazh konkurrues duke i siguruar burimet e nevojshme për të pasur qasje tek një numër më i madh i votuesve të tyre brenda një periudhe më të shkurtë kohore.

Fushata zgjedhore ishte kryesisht e qetë me disa akuzime për grisje të posterëve dhe mbulimit të shumicës së tabloidëve të partive më të vogla nga partitë më të mëdha. Prania e partisë në pushtet mund të ndihej shumë në media përmes spoteve dhe debateve të tyre televizive.¹³ Partitë shfrytëzuan mënyra të ndryshme për t'ju drejtuar qytetarëve, ku më të zakonshmet ishin fjalimet publike.

Mediat kryesisht u përqendruan në debate me kandidatët nga partitë e ndryshme politike. Këto debate ishin të fokusuara në çështje të ndryshme, ndonëse mundësia e moderatorit për t'i mbajtur debatuesin të përqendruar në disa raste nuk ka qenë e kënaqshme.¹⁴ Me përjashtimin e dukshëm të disa prej partive të vogla, debatet dhe fjalimet nuk ishin të

¹² Intervistë e KIPRED-it me anëtarin e KQZ-së, Ilir Fetahu më 16 mars 2010.

¹³ Instituti kosovar për hulumtim dhe zhvillim të politikave. Monitorimi i fushatës zgjedhore. Dhjetor 2010.

¹⁴ Po aty.

përqendruara në programet e partive politike, por në personalitete.¹⁵ Disa parti nuk kanë prezantuar programe, përfshirë këtu LDK-në.

Në përgjithësi fushata zgjedhore ishte e qetë, e karakterizuar me synimin e elektoratit të zakonshëm të tyre nga partitë dhe subjektet politike. Kjo ndodhi kryesisht për shkak të shkurtësisë së fushatës. Gjatë kësaj kohe, prania e partive politike është ndjerë shumë në televizione, ku shumica dërmuese e spoteve reklamuese ishin materiale promovuese të partive politike.

DITA E ZGJEDHJEVE

Në mëngjesin e ditës së zgjedhjeve shumica e vendvotimeve u hapën nëpër Kosovë duke shënuar kështu zgjedhjet e para parlamentare pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Një numër i organizatave të shoqërisë civile monitoruan zgjedhjet, duke përfshirë më shumë se 5000 persona në këtë proces. Gjithashtu, parlamentarët e BE-së dhe zyrtarët ndërkombëtarë, përfshirë ambasadorin e ShBA-ve në Kosovë, morën pjesë në procesin e monitorimit.

Për të garantuar sigurinë e zgjedhjeve dhe të votave, ngjashëm me praktikën e zgjedhjeve pas luftës së vitit 1999 në Kosovë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përdori disa metoda. KQZ-ja i siguroi vendvotimeve listat e tërë votuesve të regjistruar për secilin vendvotim, përfshirë fotografitë e tyre dhe informatat e letërnjoftimit. Së bashku me metodën e lartpërmendur të identifikimit, KQZ-ja përdori një spërkatës me ngjyrë të padukshme për të shënjuar personat që kanë votuar. Kjo ngjyrë mund të dallohet nga dritat ultravjollcë (UV). Për këtë arsye KQZ-ja siguroi llamba me bateri që transmetojnë dritë ultravjollcë.

Në ditën e votimit, vendvotimet u hapën në ora 7 të mëngjesit, siç parashihet me ligj, ndërsa kishte edhe disa vendvotime që u hapën pak më vonë. Këto vonesa ishin të lidhura me disa probleme me materialet e ndjeshme që përdoren nëpër vendvotime. Në disa raste materialet e ndjeshme, siç janë spërkatësit, fletëvotimet apo llambat, nuk kanë arritur me kohë. Një numër vendvotimesh në mbarë vendin kishin marrë llamba ultravjollcë jofunksionale. Kjo ishte për shkak të cilësisë së dobët të llambave apo për shkak të problemeve me bateritë. Në një numër të vogël të vendvotimeve ky problem kishte vazhduar gjatë tërë ditës.

Për shkak të protestave dhe thirrjeve publike për të mos votuar, të kombinuara me disa kërcënime, vendvotimet në veri të Kosovës nuk ishin hapur. Në vend të kësaj, disa vendvotime mobile kanë lëvizur nëpër pjesën veriore të Kosovës. Edhe me masat e ndërmarra për të mos shqetësuar situatën në veri të Kosovës përmes angazhimit të vendvotimeve mobile, vendasit në Zveçan penguan procesin duke bllokuar një nga vendvotimet dhe duke suspenduar përkohësisht procesin zgjedhor. Megjithatë, votimi në enklavat serbe në pjesën jugore të Kosovës ishte i kënaqshëm.

Rastet e para të parregullsive u raportuan nga mediat menjëherë pas hapjes së qendrave të votimit lidhur me mosfunksionimin e llambave ultravjollcë dhe spërkatësin shumë të dobët të

¹⁵ Po aty. 13 dhe intervista e KIPRED-it me Muhamet Hajrullahun, redaktor menaxhues, BIRN. Mars 2010.

ngjyrës së padukshme. Në fakt, për herë të parë në histori të zgjedhjeve në Kosovë mediat ishin shumë aktive në raportimin e parregullsive në mbarë vendin, shumë më shumë sesa shumica e organizatave për monitorimin e zgjedhjeve. Katër transmetues vendor dhe një kabllor, kishin angazhuar ekipe që raportonin drejtpërdrejtë nga mbarë Kosova.

Në orët në vijim, procesi zgjedhor u karakterizua nga një varg parregullsish të raportuara nëpër mediat vendore dhe ndërkombëtare. Përveç çështjeve të vogla, siç janë promovimi i partive politike nga ana e militantëve nëpër vendvotime dhe shkelja eventuale e heshtjes zgjedhore përmes materialeve promovuese, siç janë porositë përmes telefonit, kishte akuza serioze të presionit ndaj votuesve dhe vëzhguesve të zgjedhjeve.

Organizatave të shoqërisë civile dhe partitë politike raportuan se vëzhguesve dhe komisionarëve të tyre u ishte ndaluar qasja në vendvotime dhe ishin kërcënuar me dhunë. Këto fenomene janë dokumentuar gjatë ditës edhe pse kishte një shkallë të caktuar të vet censurimit të ushtruar nga një numër i organizatave të shoqërisë civile, posaçërisht kur marrim parasysh shkallën e raportimit të parregullsive nëpër media.

Një problem tjetër i vërejtur gjatë zgjedhjeve ishte praktika e votimit të dyfishtë, ku një individ voton më shumë se një herë në një vendvotim apo në ndonjë tjetër. Ky problem ishte i përhapur në mbarë vendin, me theks më të madh në bastionet e partive politike. Përveç ndikimit negativ të dukshëm në rezultatet e zgjedhjeve, kjo shërben edhe për të dëshmuar brishtësinë e masave të sigurisë të ndërmarra nga KQZ-ja dhe mungesën e përgjegjësisë së personelit nëpër vendvotime.

Organizatave të shoqërisë civile dhe institucionet e tjera që kanë monitoruar zgjedhjet kanë vërejtur se numri i parregullsive është ngritur afër mbylljes së ditës së zgjedhjeve. Në fund të ditës së zgjedhjeve kishte raporte të shumta të komisionarëve që ishin larguar me forcë nga vendvotimet dhe të pretendimeve të shumta të mbushjes së kutive, përfshirë raporte nga ambasadorët e huaj që shërbyen si monitorues të zgjedhjeve. Këto pretendime u plotësuan me video dhe fotografi të mbushjes së kutive që u publikuan në internet dhe u transmetuan nga mediat.

DV-ja ka kontestuar zgjedhjet në dy qytete, ku mbi 80% e votuesve të regjistruar kinse kishin hedhur votën, por kjo ishte bërë shumë kohë pasi informatat ishin bërë publike dhe partitë dhe organizatat e tjera veçse kishin ngritur dhe dorëzuar shqetësimet e tyre. Megjithatë, kishte shumë akuza në lidhje me mungesën e efikasitetit të menaxhmentit të DV-së në procesin e monitorimit. Në fakt, disa nga vet vëzhguesit e DV-së u dyshuan për mbushje të kutive. Gjithashtu, kishte dyshime tek menaxhmenti për mos grumbullim dhe raportim të parregullsive me kujdes dhe në kohë reale.

Akuzat e bëra nga partitë politike dhe nga pjesëtarët e shoqërisë civile u konfirmuan disi gjatë konferencës për media të KQZ-së në ora 22:00 ku ata verifikuan praninë e pjesëmarrjes të mbi 90% të votuesve të regjistruar në disa qendra të votimit. Dalja e përgjithshme e votuesve ishte 47.8% dhe një numër i konsiderueshëm i njerëzve të regjistruar në disa qendra të votimit jetojnë jashtë vendit, duke e bërë daljen prej 90% shumë të pazakontë.

Duke pas parasysh parregullsitë e regjistruara dhe videot e mbushjes së kutive që qarkulluan në publik gjatë ditës së votimit, pritshmëritë ishin se institucionet e pavarura të vëzhgimit do të ishin më të zëshme në raportimin e të gjeturave të tyre. Por në vend të kësaj të gjeturat janë minimizuar me të madhe dhe injoruar në disa raste specifike, si në rastet e votimit të dyfishtë dhe të votimit familjar¹⁶. Jakup Krasniqi, që atëherë ishte ushtrues i detyrës së presidentit të Republikës së Kosovës e quajti procesin zgjedhor “të lënduar”¹⁷ Kjo demonstroi se problemi nuk ishte vetëm me zgjedhjet e parregullta, por edhe me vëzhguesit, ku shoqëria civile me të madhe dështoi në përmbushjet e rolit të saj të mbikëqyrësit të pavarur.

ANKESAT DHE PARASHTRESAT

Sipas ligjit të amendamentuar për zgjedhje, palët e përfshira në procesin zgjedhor dhe të monitorimit kanë 24 orë kohë për të dorëzuar ankesat e tyre në PZAP. Në 24 orët menjëherë pas mbylljes të vendvotimeve, PZAP-ja pranoi 363 ankesa dhe parashtresa nga partitë politike dhe nga organizatat që monitoruan zgjedhjet. PZAP-ja pranoi gjithsej 454 ankesa dhe parashtresa për zgjedhjet dhe rizgjedhjet e vitit 2010.¹⁸

Numri i ankesave të dorëzuara është relativisht i vogël kur krahasohet me pretendimet e parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve. Kjo është për shkak të faktit se subjektet e përfshira në procesin e monitorimit të zgjedhjeve nuk ishin të informuara mirë për afatin kohor që kishin për dorëzimin e ankesave. Kjo mund të shihet qartë në komunikatat për shtyp të këtyre subjekteve pas përfundimit të periudhës prej 24 orësh për dorëzimin e ankesave.

Gjithashtu, KQZ-ja nuk ka të drejtë ligjore të marrë vendime në ato raste kur nuk dorëzohen ankesa. Në rastin e Skenderajt, KQZ-ja nuk kishte mundësi t'i anulonte rezultatet e zgjedhjeve pavarësisht se aty problemi ishte i qartë sepse 93% e të gjithë votuesve kishin votuar dhe kishte pasur akuza serioze të mashtrimit. Kjo ishte e lidhur me afatin kohor të shkurtë për dorëzimin e ankesave në PZAP dhe me faktin se parregullsitë kishin ndodhur kryesisht në bastionet e partive që nuk kishin gatishmërinë të dorëzonin ankesa. Këta faktorë ndikuan në numrin relativisht të vogël të ankesave të dorëzuara në PZAP dhe treguan një tendencë të minimizimit të problemeve që lidhen me zgjedhjet e dhjetorit 2010.

Ky fenomen, megjithatë, nuk vlen për subjektet e tjera që kanë monitoruar zgjedhjet. Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese ka funksionuar me një buxhet dhe numër të kufizuar të vëzhguesve, por ka dorëzuar 39 ankesa në PZAP, shumica prej të cilave ishin pranuar.¹⁹ Ndërsa Demokracia në Veprim, me mbi 5000 monitorues, nga dy monitorues për vendvotim,

¹⁶ Votimi familjar është procesi ku një familje e tërë apo një grup më i madh i personave të afërm shkojnë në vendvotime dhe votojnë së bashku. Ndonëse teknikisht nuk ka asgjë të keqe me këtë fenomen, zakonisht shihet si përpjekje për të kontrolluar votat e anëtarëve të familjes.

¹⁷ "12 Dhjetori i Lënduar," Zijadin Gashi, 29 dhjetor 2010. Radio Evropa e Lirë.

<http://www.evropaelire.org/content/article/2262477.html>

¹⁸ PZAP, Mul Desku Kryesuesi i sekretariatit, korrespondenca me KIPRED.

¹⁹ Intervistë e KIPRED-it me Muhamet Hajrullahun, redaktor menaxhues, BIRN. Mars 2011.

dhe me financim më të mirë, ka dorëzuar vetëm katër ankesa, përfshirë këtu rizgjedhjet.²⁰ Ndërsa mund të thuhet se partitë politike ndoshta nuk janë informuar rreth procedurës së dorëzimit të ankesave, këto organizata janë formuar në mënyrë specifike për atë qëllim, andaj mungesa e informatave nuk mund të jetë arsye për efikasitetin e dobët. Këto shifra shërbejnë për të treguar se përkushtimi, profesionalizmi apo mungesa e tyre gjithashtu kanë luajtur një rol të rëndësishëm në numrin e ankesave të dorëzuara.

Ankesat kryesisht ishin të përqendruara rreth fenomenit të votimit të dyfishtë, spërkatësve dhe llambave që nuk funksiononin, faktit se kishte më shumë votues sesa persona të regjistruar për të votuar, etj.

Pas ankesave që janë dorëzuar, PZAP-ja dha urdhër për rizgjedhje në Skenderaj, Drenas dhe Deçan, si dhe në dy vendvotime, një në Lipjan dhe tjetri në Malishevë, ku kishte dëshmi të mashtrimeve. Në anën tjetër "Vetëvendosja" dorëzoi një ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës lidhur me parregullsitë e shumta në komunën e Mitrovicës. Gjykata Supreme vendosi për rizgjedhje në qytetin e Mitrovicës. Megjithatë, KQZ-ja veçse kishte shpallur rizgjedhje në dy komuna të vogla, pa pritur vendimin e Gjykatës Supreme për Mitrovicën.

Rrjeti Evropian i Organizatave për Monitorimin e Zgjedhjeve (ENEMO) bëri thirrje për ndjekjen penale të rasteve të parregullsive që ishin dorëzuar në PZAP. Kjo organizatë gjithashtu theksoi se rastet që kishin të bënin me zgjedhjet ishin lënë të pazgjidhura që nga viti 2007 dhe 2009 dhe ftoi prokurorinë që t'i zgjidhë edhe këto probleme.²¹

Pavarësisht akuzave të shumta për mashtrime dhe numrit të ankesave dhe vendimeve përkatëse për rizgjedhje që janë parashtruar në PZAP dhe Gjykatë Supreme, KQZ-ja publikoi rezultatet preliminare të zgjedhjeve. Për më shumë, mediat në Kosovë publikuan një dokument me votat për kandidatët partiak që kishe rrjedhur nga KQZ. Këto veprime patën ndikim në rezultatet e rizgjedhjeve brenda komunave ku disa parti të vogla refuzuan të marrin pjesë. Megjithatë, efekti më i madh mund të ndihej brenda partive politike, me zhvendosje/ndryshime të konsiderueshme të votave për kandidatët e tyre.

RIZGJEDHJET

Pas ankesave dhe parashtresave për zgjedhjet e 12 dhjetorit 2010, PZAP-ja vendosi që të mbajë rizgjedhje në tri komuna dhe dy vendvotime në dy komuna të tjera. Fushata zgjedhore për këtë raund të rizgjedhjeve zgjati vetëm tri ditë. Megjithatë, për shkak se KQZ-ja publikoi rezultatet preliminare, disa parti të vogla u tërhoqën nga gara. Kjo ndodhi edhe me partitë minoritare, duke parë se nuk kishin pothuajse fare elektorat në komunat që shkuan në rizgjedhje.

²⁰ Sipas drejtuesit të DnV, Ismet Kryeziu, kjo organizatë nuk e ka pasur në mandat dorëzimin e ankesave. Tryeza e Rrumbullakët për diskutimit e këtij punimi, Hotel Grand, Prishtinë, Prill, 2011.

²¹ Rrjeti evropian i organizatave për monitorimin e zgjedhjeve – Komunikata për shtyp rreth zgjedhjeve të përgjithshme dhe balotazhit të Kosovës – janar 2011.

http://www.enemo.eu/press/ENEMO_press_release_KOSOVO_EOM_ENG_12.01.2011.pdf

Raundi i parë i rizgjedhjeve u mbajt më 9 janar 2010 në Skenderaj, Drenas, Deçan dhe në dy vendvotime në Malishevë dhe Lipjan. Këto zgjedhje u karakterizuar me parregullsi në veçanti kur merret parasysh numri i ankesave dhe parashtrësive lidhur me to. Indikacioni më i qartë i parregullsive në ditën e zgjedhjeve të para dëshmohej me faktin se në Drenas dhe Skenderaj rizgjedhjet sollën diku rreth 30,000 votues, apo 25%, më pak dalje në votime. Ky është tregues i votimeve të dyfishta dhe i mbushjes së mundshme të kutive.

Rizgjedhjet gjithashtu u shënuan me probleme serioze siç janë pasqyruar në ankesat dhe parashtrësit e dorëzuara nga entitetet e ndryshme monitoruese pas 13 janarit 2010. KQZ-së i është dashur të urdhërojë rinumërim të votave në tetë vendvotime në të tri komunat²².

VV dorëzoi në PZAP ankesa lidhur me mosfunksionimin e llambave ultravjollcë në disa vendvotime të caktuara të komunës së Mitrovicës dhe kërkuan rizgjedhje. PZAP-ja vendosi kundër rastit. Pas vendimit të PZAP-së, VV apeloi rastin në Gjykatën Supreme, e cila vendosi në favor të rizgjedhjeve më 23 janar 2011 në atë komunë. Apeli është arsyeja e mbajtjes së dy raundeve të ndryshme të rizgjedhjeve. Partitë politike të vogla që fituan një numër të vogël të votave në zgjedhjet fillestare refuzuan të merrnin pjesë në rizgjedhje. Shumica e elektoratit të tyre nuk dolën në votime duke bërë kështu që numri i personave që kanë dalë në votime të jetë më i ulët.

RINUMËRIMI

Kur vendvotimet u mbyllën më 12 dhjetor 2010, komisionarët ishin përgjegjës për plotësimin e dy formularëve. Formulari i parë përmbante informatën për numrin e gjithëmbarshtëm të votave të fituara nga një subjekt politik, ndërsa në formularin e dytë llogariteshin votat e fituara nga kandidatët brenda subjektit politik. Duke marrë parasysh se çdo votues ka mundur të zgjedhë një parti politike dhe pesë kandidatë brenda asaj partie politike, gjithsej raporti mes votave për parti me ato për kandidat është dashur të jetë përafërsisht 1:5. Kur doli raporti nga Qendra e Numërimit të Votave, KQZ-ja vërejti se ky proporcion nuk ishte as afër normales²³. Pas kësaj KQZ-ja urdhëroi që votat të rinumërohen në 740 qendra të votimit apo 40% të të gjitha qendrave të votimit në vend. Ka shqetësime se një praktikë e tillë ka ndodhur edhe në 60% të vendvotimeve të tjera në vend, megjithatë raporti 1:5 nuk ishte prishur dhe rrjedhimisht nuk ka pasur vendim për rinumërim. Sidoqoftë, vendimi për rinumërimin e 40% të numrit të gjithëmbarshtëm të qendrave të votimit qartazi paraqet një trend shqetësues.

Duke marrë parasysh se listat kanë qenë të hapura, një pjesë e qytetarëve kanë zgjedhur subjektet politike jo për shkak të vet subjektit, por për shkak të kandidatit brenda atij subjekti. Për një pjesë të votave që janë hedhur për kandidatët e caktuar, ndërhyrja në votat e kandidatëve do të thotë shkelje e drejtpërdrejtë e votave të qytetarëve. Për më tepër, vendimi për rinumërim të votave në një numër kaq të madh të qendrave të votimit tregon se vullneti i

²² Vendimi i KQZ-së nr. 88-2011 lëshuar më 15.01.2011.

²³ Intervistë e KIPRED-it me Ilir Fetahun, anëtar nga LDD në KQZ, 16 mars 2011.

qytetarëve është shkelur nga komisionarët, të cilët kanë ndërhyrë në procesin e numërimit me qëllim të favorizimit të kandidatëve të caktuar.

IV TRENDËT E VOTIMIT NË ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME TË VITIT 2010

Në kuadër të përpjekjeve për të parashikuar më mirë rezultatet dhe dinamikën e zgjedhjeve të ardhshme si dhe për një minimizim potencial të mashtrimeve masive, KIPRED-i bën analizën e trendëve të votimit. Këto trendë janë specifike për partitë më të mëdha shqiptare dhe ato të pakicave dhe ndihmojnë në përkufizimin e një pamjeje më konkrete të mozaikut elektoral dhe politik në Kosovë.

Pjesëmarrja elektorale

Në vitin 2010, KQZ-ja regjistroi një ngritje prej 68,335 votuesve apo një ngritje prej 4.2% nga zgjedhjet e vitit 2009. Kjo ngritje e numrit të votuesve alarmoi monitoruesit dhe analistët për shkak të një rritje kaq të madhe në një kohë të papritur.

Ndonëse mund të vijmë në përfundim se ngritja e dëshmuar në vitin 2010 nuk është konsiderueshëm e lartë në krahasim

Viti ²⁴	Elektorati
2000	913,179
2001	1,249,987
2002	1,320,481
2004	1,412,680
2007	1,567,690
2009	1,563,741
2010	1,632,276

me vitet e tjera, arsyeja për shifrat e larta në vitet paraprake shpjegohet lehtë. Në vitet e para pas luftës së vitit 1999, listat e votuesve rifreskoheshin në mënyrë konstante për shkak të atyre që ktheheshin në Kosovë qoftë nga zhvendosja ose nga emigrimi.

Gjithashtu, nëse i shikojmë tabelat, mund të shohim një rritje prej 9.89% të numrit të votuesve të regjistruar nga viti 2004 në vitin 2007. Kjo ngritje e numrit të votuesve erdhi si rezultat i mos përditësimit të listës së votuesve. Kjo dëshmohet edhe me rënien e numrit të votuesve nga viti 2007 në viti 2009, që ishte rezultat i përditësimit të listës së votuesve nga personat që më

nuk mund të votojnë apo që nuk kanë të drejtë të votojnë.

Sipas zyrtarëve të KQZ-së, ngritja e numrit të votuesve në vitin 2010 kryesisht mund t'i atribuohet dy faktorëve madhorë. Përafërsisht 30,000 votues janë regjistruar këtë vit për shkak të arritjes së moshës, numër ky që vërehet vazhdimisht gjatë viteve. Diferenca tjetër shpjegohet nga regjistrimi i serbëve dhe i pakicave të tjera për të marrë pjesë në zgjedhje si dhe regjistrimi i emigrantëve që arrijnë moshën për të votuar²⁵. Të dy këto pretendime mund të arsyetohen disi kur shikohet pjesëmarrja e kënaqshme e serbëve në zgjedhjet e

²⁴Burimi: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në <http://www.kqz-ks.org>

²⁵ Intervistë e KIPRED-it me Ilir Fetahun, anëtar nga LDD në KQZ, 16 mars 2011.

përgjithshme të Kosovës në vitin 2010, si dhe tendenca e shqiptarëve të Kosovës për të emigruar gjatë fillimit të viteve të nëntëdhjeta. Kjo do të thotë se fëmijët e atyre emigrantëve tani kanë arritur moshën për t'u regjistruar dhe votuar. Megjithatë, ka një dozë rezerve kundrejt këtij shpjegimi dhe ngritja e numrit të votuesve dhe trendët gjatë këtij viti janë brengosëse dhe duhet të monitorohen nga afër.

Viti ²⁶	Dalja	
2000	721,260	79.00%
2001	803,796	64.30%
2002	711,205	53.90%
2004	699,519	49.50%
2007	628,630	40.10%
2009	709,362	45.40%
2010	739,437	45.30%

Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010, dalja e përgjithshme e votuesve ishte 110,807 më shumë se në vitin 2007, pavarësisht ngritjes prej 68,535 personave të elektoratit të përgjithshëm të vitit 2010.

Votat me kusht dhe votat e pavlefshme

Votat me kusht							
2001		2004 ²⁷		2007		2010	
Të vlefshme	Të pavlefshme	Të vlefshme	Të pavlefshme	Të vlefshme	Të pavlefshme	Të vlefshme	Të pavlefshme
44,359	13,610			26,791	7,000	24,867	1,340
57,969		39,814		33,791		26,207	
7,21%		5,69%		5,38%		3,54%	

Burimi: KQZ në <http://www.kqz-ks.org> dhe OSBE në <http://www.osce.org/kosovo/43390>

Siç mund të shihet në tabelën më lartë, ekziston një trend i uljes të votave me kusht. Këto janë votat që janë hedhur brenda shtetit, por jo brenda vendvotimeve të përcaktuara. Kjo është kryesisht për shkak se listat janë pastruar nga personat që nuk mund të votojnë apo që nuk kanë të drejtë të votojnë. Një arsye tjetër është rritja e profesionalizmit në fushatat për

²⁶ Burimi: KQZ në <http://www.kqz-ks.org>

²⁷ Nuk ka të dhëna nga OSBE-ja për numrat e votave me kusht të vlefshme dhe të pavlefshme nga viti 2004.

edukimin e votuesve që ndihmon në informimin e tyre rreth vendvotimeve të përcaktuara. Gjithashtu, Kosova ka përjetuar një migrim konstant të brendshëm dhe lehtësimi i procedurave të regjistrimit në lokacione të tjera ndihmon në uljen e numrit të votave me kusht.

Siç u theksua më lartë, edukimi i votuesve është përmirësuar gjatë vitit duke kontribuar kështu në uljen e vazhdueshme të trendit të numrit të votave të pavlefshme. Kulmi i votave të pavlefshme në vitin 2007 është për shkak

Votat e pavlefshme				
	2001	2004	2007	2010
Votat e zbrazëta	0,44%	0.39%	3.50%	1%
Votat e pavlefshme	1,49%	0.96%	5.55%	3.95%
Gjithsej	1,93%	1.35%	9.05%	4.6%
Burimi: KQZ në http://www.kqz-ks.org				

të vendimit për të hapur listat e kandidatëve të partive politike – para vitit 2007 është votuar vetëm për partitë politike. Në vitin 2010, faktori i vetëm që ndryshoi është numri i kandidatëve që votuesi mund të votonte, nga 10 deri 5 kandidatë.

		Votat e drejtpërdrejta	LDD+FER	Të rezervuara (kuota)	Gjithsej vende
Partitë shqiptare	PDK	33	1		34
	LDK	26	1		27
	VETVENDOSJE!	13	1		14
	AAK	11	1		12
	AKR	8			8
	LDD	2			
	FER	2			
Partitë e tjera të pakicave	KDTP	1		2	3
	VAKAT	1		1	2
	BSDAK	0		1	1
	GIG	0		1	1
	PREBK	0		1	1
	PDAK	0		1	1
	IRDK	0		1	1
	NDS	0		1	1
	PAI	0		1	1
Partitë serbe	SDSKIM	0		1	1
	JSL	1		3	4
	SLS	2		6	8
	Gjithsej	100	4	20	120
Burimi: KQZ në http://www.kqz-ks.org					

Nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010, PDK-ja doli si partia më e votuar ndërsa LDK-ja ishte e dyta, pastaj VV dhe AAK. Katër partitë më të mëdha morën ulëset e tyre të fituara plus nga një ulëse për secilën që përndryshe do t'u ishte dhënë partive që do të kishin kaluar pragun prej 5%, pra LDD-së dhe FER-it.

Partitë serbe treguan një interesim më të madh për të marrë pjesë në zgjedhje këtë vit, përmes fushatave zgjedhore dhe përmes deputetëve të zgjedhur e jo vetëm të caktuar nga kuota. Kushtetuta e Kosovës parasheh që 10 ulëse të Kuvendit të rezervohen për komunitetin serb përveç nëse numri i përgjithshëm i ulëseve të fituara nga subjektet serbe është më shumë se dhjetë. Partia liberale serbe (SLS) fitoi dy ulëse përmes votave dhe gjashtë ulëse përmes kuotës. SLS-ja paraqet të vetmin rast ku personi i katërt në listën e kandidatëve nga partia mori më shumë vota se personi i parë në listë. Lista e bashkuar serbe (JSL) fitoi një ulëse përmes votave edhe pse ishte e re në skenën politike.

Partia	Renditja sipas komunave		
	E para	E dyta	E treta
LDK	5	18	6
PDK	21	4	4
AAK	4	2	4
VV	-	3	12
AKR	-	2	2
Burimi: KQZ në http://www.kqz-ks.org			

Nga tabela mund të shohim se PDK-ja ishte partia që fitoi në shumicën e komunave me një margjinë të gjerë me garuesin e dytë.

Edhe në kuadër të rezultateve të zgjedhjeve sipas komunave, LDK dukshëm është partia e dytë fituese. AAK zakonisht ka prirë në katër komuna, Pejë, Gjakovë, Deçan dhe Suharekë por këtë rradhë arriti të jetë e para vetëm në tre nga ato katër komuna, duke humbur Suharekën. LVV ka qenë befasia e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2010, ku doli partia e tretë më e votuar në pothuajse të gjitha komunat. Befasuese është edhe se kjo listë qytetare doli e dyta në dy komunat më të mëdha, në Prishtinë dhe Gjiilan, që de-facto e dëshmon këtë si

partia e dytë më e fuqishme.

Partitë politike

PDK

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) doli të jetë partia më e madhe dhe më e përhapur në mbarë Kosovën. Përpos në Prishtinë, kjo parti gëzoi ngritje të elektoratit në mbarë Kosovën në krahasim me zgjedhjet e vitit 2007. Në 21 komuna PDK-ja ishte partia e parë ndërsa në katër komuna të tjera kjo parti ishte e dyta ose e treta. Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2010, PDK-ja arriti

PDK		
Viti	Nr i votave	%
2001	202,622	25.70%
2004	199,112	28.85%
2007	196,207	34.30%
2010	224,339	32.11%
Burimi: KQZ në http://www.kqz-ks.org		

numri më të lartë të votave që është shënuar ndonjëherë për një parti të vetme.

Në përgjithësi, kjo parti fitoi 23,132 më shumë vota, apo 14.34%, mbi votat e tyre të përgjithshme të vitit 2007. Pavarësisht rezultateve të përgjithshme më të mira, PDK-ja humbi dy deputetë në këto zgjedhje krahasuar me zgjedhjet e vitit 2007. Megjithatë, vetëm në Skenderaj dhe Drenas partia fitoi 21.46% të votave të saj, duke pas parasysh faktin se rajoni i Drenicës është bastion i votuesve të PDK-së. E veçanta e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2010 është komuna e Suharekës, bastion ky i njohur i LDK-së me kryetar nga radhët e AAK-së, por ku PDK-ja fitoi zgjedhjet me 6% më shumë vota se AAK-ja.

LDK

Në krahasim me vitin 2007, kjo parti arriti të rrisë numrin e elektoratit të vet për 33.34% apo 43,142 më shumë votues. Megjithatë, partia fitoi më pak se gjysmën e votave të përgjithshme që i grumbulloi në zgjedhjet e para të përgjithshme të mbajtura në vitin 2001. LDK-ja fitoi rreth 37%, apo 67,310 vota, në komunat rreth Prishtinës, (Podujevë, Obiliq, Fushë Kosovë dhe Lipjan) dhe nga shtatë qendrat madhore në Kosovë arriti të jetë e para në Prishtinë. Kjo është kryesisht për shkak të faktit se lideri i partisë është edhe kryetar i komunës së Prishtinës.

LDK		
Viti	Nr i votave	%
2001	359,851	45.65%
2004	313,437	45.42%
2007	129,410	22.60%
2010	172,552	24.69%
Burimi:KQZ në http://www.kqz-ks.org		

AAK

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) hyri në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010 pa liderin e vet, Ramush Haradinaj, për shkak të gjykimit të tij në Hagë. Pavarësisht nga hendikepi i të qenit pa lider, partia u fuqizua me marrjen e disa deputetëve nga LDK-ja dhe dy deputetëve të pavarur të njohur për fillimin e rastit gjyqësor kundër ish-presidentit Fatmir Sejdiu. Në vitin 2010, AAK-ja shënoi një ngritje prej 22,519 votues apo 41.24% më shumë se votat e saja të përgjithshme në zgjedhjet parlamentare të vitit 2007. Kjo ishte ngritja më e madhe e votuesve e shënuar në mesin e partive të kuvendit. Pavarësisht përpjekjeve të tyre për t'u distancuar nga perceptimi i një partie nga rajoni i Dukagjinit (Pejë, Junik, Deçan, Gjakovë, Klinë dhe Istog) partia fitoi 45.74% të votave të tyre të përgjithshme në këto qytete. Në katër komuna dhe dy qendra madhore nga ky rajon, AAK-ja ishte partia e parë.

AAK		
Viti	Nr i votave	%
2001	61,668	7.83%
2004	57,931	8.39%
2007	54,611	9.60%
2010	77,130	11.04%
Burimi:KQZ në http://www.kqz-ks.org		

Vetëvendosje!

VV u themelua si lëvizje qytetare në vitin 2004 dhe u karakterizua nga protestat kundër zgjedhjeve dhe kundërshtimin të çdo lloji të bisedimit me Serbinë. Kjo lëvizje hyri në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010 si listë qytetare në koalicion me dy parti, programi i të cilave është bashkimi kombëtar me Shqipërinë. Nga këto zgjedhje VV doli fuqia politike e tretë në vend, ndërsa si subjekt ata ishin përgjegjës edhe për shumicën e ankesave që u dërguan në PZAP.

VV		
Viti	Nr i votave	%
2010	88,652	12.69%
Burimi:KQZ në http://www.kqz-ks.org		

Me 15,899 vota, apo 17.93% të votave të tyre të përgjithshme në vitin 2010, VV është regjistruar të jetë partia politike e dytë për nga madhësia në Prishtinë. Kjo është e vërtetë edhe për Gjilanin, duke prishur kështu radhitjen politike mes PDK-së dhe LDK-së në këto qytete. VV gjithashtu ishte subjekti i dytë i votuar në Kaçanik, ndërsa në 12 komuna të tjera ishte e treta.

AKR²⁸

Aleanca Kosova e re (AKR) hyri në zgjedhjet e vitit 2010 në koalicion me 6 parti të tjera, mes së cilave ishin Partia e drejtësisë (PD) dhe Partia Socialdemokrate e Kosovës (PSD). Këto parti shënuan një ngritje të qëndrueshme të elektoratit në vitet e fundit. Edhe pas suksesit të kandidatit të tyre në Gjakovë në zgjedhjet lokale në vitin 2009, AKR-ja humbi një të tretën apo 27.38% të elektoratit kur krahasohet me zgjedhjet e vitit 2007. Partia fitoi 40.24% të votave të tyre të përgjithshme në Prishtinë dhe Gjakovë, që dëshmon faktin se partia ka humbur një pjesë të votuesve të saj tradicional. Megjithatë, për shkak të negociatave pas zgjedhjeve, ky grup tani është pjesë e koalicionit qeverisës, kryesisht për shkak të një marrëveshje për ta bërë liderin e AKR-së president të Republikës së Kosovës.

AKR		
Viti	Nr i votave	%
2007	70,165	12.30%
2010	50,951	7.29%
Burimi:KQZ në http://www.kqz-ks.org		

AKR-ja arriti të dalë e dyta vetëm në Gjakovë dhe Han të Elezit, ndërsa ishte e treta në Skenderaj dhe Zubin Potok, me më pak se 1% të votave të përgjithshme. Nga tetë anëtarët që u zgjedhën për kuvend, tre ishin nga koalicioni dhe pesë nga AKR-ja. Kur ky koalicion u bë pjesë e koalicionit qeverisës, tre anëtarë të AKR-së që ishin deputetë kaluan në ekzekutiv. Tri vendet e mbetura që ky koalicion kishte për të plotësuar me deputetë ju dhanë PD-së, duke treguar kështu që shumica e votave të fituara i takonin PD-së.

²⁸ Koalicioni AKR-PD-PSD-PPI-PPK-PNDSH-PGJK

Partitë e komunitetit serb

Ndryshe nga viti 2001, kur qeveria e Serbisë bëri thirrje që të gjithë serbët në Kosovë të bojkotonin zgjedhjet, në vitin 2010 kjo thirrje ju bë vetëm serbëve në veri të Kosovës. Kjo me siguri ndikoi në daljen e votuesve nga komuniteti serb,

		2007		2010	
Partitë serbe	SDSKIM	0.16%	3	0.14%	1
	JSL		0	0.86%	4
	SLS	0.15%	3	2.05%	8
Burimi:KQZ në http://www.kqz-ks.org					

duke shënuar një ngritje substanciale në vitin 2010. Partitë politike serbe të Kosovës fituan tri ulëse në kuvend përmes votave të drejtpërdrejta, që solli numrin e përgjithshëm të përfaqësuesve serb në Kuvend në 13.

Lista e Bashkuar Serbe (JSL) morri pjesë për herë të parë në zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë. Pavarësisht se ishin të ri në politikë, ata fituan 40% të votave të serbëve në Kosovë, ku një femër e vendosur në vend të katërt në listën e kandidatëve fitoi shumicën e votave të brendshme.

Grupi parlamentar i udhëhequr nga Partia Liberale Serbe (SLS) është i përbërë prej 12 deputetëve dhe një deputet nga SDKIM dhe JSL. Gjithashtu, dy parti politike nga komuniteti jo serb iu bashkuan grupit gjegjësisht PAI dhe GIG nga komuniteti boshnjak dhe ai goran.

Komunitetet e tjera

		2007		2010	
Partitë nga komunitet e tjera	KDTP	0.87%	3	1.22%	3
	VAKAT	0.95%	3	0.76%	2
	BSDAK		0	0.26%	1
	GIG	0.21%	1	0.11%	1
	PREBK	0.10%	1	0.10%	1
	PDAK	0.60%	3	0.41%	1
	IRDK	0.37%	1	0.24%	1
	NDS		0	0.35%	1
	PAI		0	0.20%	1
Burimi:KQZ në http://www.kqz-ks.org					

Siç mund të shohim nga tabela, asnjë entitet tjetër nga pakicat përveç partisë turke KDTP dhe koalicionit boshnjak VAKAT nuk fituan ndonjë ulëse në Kuvend, në veçanti duke pas parasysh se pragu për pakicat ishte 1%. BSDAK, NDS dhe PAI, të gjitha parti të komunitet boshnjak, nuk garuan për Kuvend në vitin 2007, por në zgjedhjet e dhjetorit të vitit 2010 të gjitha fituan nga një deputet nga ulëset e rezervuara. Në anën tjetër, partitë e tjera kanë numrin e njëjtë të votuesve, me përjashtim të PDAK-së, parti kjo nga komuniteti ashkali, që humbi 2 deputetë.

GJINIA

Partitë në Kuvend	Gjithsej deputetë	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meritë
PDK	34	23	11	34	2
LDK	27	18	9	27	7
VETËVENDOSJE!	14	9	5	14	1
AAK	12	8	4	12	1
AKR	8	5	3	8	1
SLS	8	5	3	8	0
JSL	4	2	2	4	1
KDTP	3	2	1	3	
VAKAT	2	1	1	2	
NDS	1	0	1	1	1
Gjithsej	120	80	40	120	14
Burimi:KQZ në http://www.kqz-ks.org					

Ligji për zgjedhje i Kosovës dhe Kushtetuta parashohin kuotën prej 30% për pjesëmarrjen e femrave në kuvend. Zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010 rezultuan me përfshirjen e 40 femrave në Kuvend, ose 33% të numrit të përgjithshëm të deputetëve të Kuvendit. Megjithatë, numri i pozitave me meritë është vetëm 14, që thekson se nevojitet një punë e konsiderueshme nga partitë politike dhe kandidatet femra për të ngritur numrin e deputeteve femra të Kuvendit që zgjedhen drejtpërdrejt. Siç mund të shihet nga tabela më poshtë, 14 pozitat e fituara me meritë janë të shpërndara në mënyrë jo të barabartë mes partive politike.

	F	Meritë	%
PDK	11	2	18.18%
LDK	9	7	77.78%
VETËVENDOSJE!	5	1	20.00%
AAK	4	1	25.00%
AKR	3	1	33.33%
SLS	3	0	0.00%
JSL	2	1	50.00%
KDTP	1		0.00%
VAKAT	1		0.00%
NDS	1	1	100.00%
Gjithsej	40	14	
Burimi:KQZ në http://www.kqz-ks.org			

LDK-ja ishte më së miri e përfaqësuar, ku

7 prej 9 deputeteve janë zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët. Partia më e madhe në qeveri ka proporcionin më të keq të meritës/kuotës në çështjen e deputeteve femra, ndoshta për shkak të mungesës së mbështetjes që femrat kanë në këtë parti politike. Pjesa tjetër e subjekteve nga lista ju mbetet një punë e konsiderueshme për zbatimin e politikave të komunikimit për të tërhequr dhe inkurajuar femrat që të kandidojnë për poste të deputetëve të Kuvendit.

V PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ligji i Kosovës për Zgjedhje të Përgjithshme dhe Lokale i adoptuar nga Pakoja Ahtisaari është i mbushur me mangësi të vogla që mund të amandamentohen nga institucionet e Kosovës. Sidoqoftë, së bashku, këto kanë pasoja negative në procesin zgjedhor duke prekur institucione si KQZ-ja dhe PZAP-ja.

Zgjedhjet e dhjetorit të 2010 në Kosovë dëshmuar se këto institucione, KQZ-ja më shumë se PZAP, nuk i kishin predispozitat ligjore për tu përballuar me problemet që mund të dalin nga zgjedhjet. Si rezultat, KQZ-ja nuk mund të marrë vendime mbi parregullsi menjëherë por është e detyruar të presë parashtrësën e ankesave në PZAP. PZAP, në anën tjetër, ka një hapësirë prej vetëm 24 orësh për të pranuar ankesa dhe parashtrësja dhe 72 orë të tjera për të vendosur mbi këto ankesa. Duke konsideruar llojet e ndryshme dhe sasinë e parregullsive në një demokraci të re si Kosova, hapësira kohore e PZAP është shumë e vogël për të bërë parashtrësja dhe vendime të duhura.

Për më shumë, ana teknike e zgjedhjeve lë shumë hapësirë për përmirësim. Mos funksionimi i llambave, kualiteti i ulët i ngjyrës të padukshme, masat e jo adekuate të sigurisë në qendra të votimit si dhe probleme të tjera të cilat mund të ishin anashkaluar lehtë tregojnë se ka një problem të përgjithshëm me organizimin e zgjedhjeve.

Gjithashtu, Kosova duhet të rregullojë një problem serioz me listën e votuesve. Mendohet se këto lista kanë një numër të lartë të njerëzve të cilat kanë ndërruar jetë ose janë të paaftë apo nuk kanë të drejtë të votojnë. Ky fenomen le hapësirë për përpunimin e dokumenteve të falsifikuara të identifikim që mund të përdorën për votime të dyfishta apo mbushje të kutive të votimit.

Pa marrë parasysh faktin që KQZ ka pasur një buxhet prej vetëm 2.5 euro për secilin votues të regjistruar, dhe periudhën e shkurtër 45 ditore për përgatitjen e zgjedhjeve është përgjegjësia e tyre që të sigurojnë kualitetin e zgjedhjeve.

Ky kualitet gjithashtu duhet të reflektohet tek stafi që punon në vendvotime. Këta persona, të punësuar për të ruajtur votat e qytetarëve duhet të trajnohen në mënyrë adekuate dhe vetëm pas këtij trajnimit të certifikohen. Ata duhet të jenë në gjendje të tregojnë integritet të jashtëzakonshëm dhe të mbrohen mirë nga presioni i jashtëm në mënyrë që të anashkalohet votimi i dyfishtë, mbushja e kutive, presioni ndaj votuesve, etj.

Çështja e profesionalizmit të personave që punojnë në vendvotime gjithashtu varet nga fakti që thyesit e ligjit nga zgjedhjet e mëparshme akoma nuk janë akuzuar. Me informatat e pakta të cilat ne i disponojmë, këta persona fajtorë mund të kenë pasur ndikim edhe në këto zgjedhje. Pa akuza adekuate kundër thyesve të ligjit, nuk do të ketë një politikë të qartë që do të penalizojë aktet e paligjshme gjatë zgjedhje duke lënë kështu shumë hapësirë për parregullsi.

Nga ana tjetër, monitoruesit e zgjedhjeve, gjegjësisht shoqëria civile dhe mediat, kanë qenë më të fokusuar në rezultatet e zgjedhjeve sesa me vetë procesin. Kjo evidencohet në heshtjen e përgjithshme mbi parregullsitë që janë vënë re gjatë zgjedhjeve dhe problemet më serioze që i kanë mundur këto parregullsi. Si rezultat, reagimi jo politik ndaj zgjedhjeve nuk ka qenë i

kënaqshëm dhe ka treguar se ka nevojë për forcimin e rrolit monitorues të shoqërisë civile ndaj procesit zgjedhor. Monitorimi i pavarur është i rëndësishëm për shkak se parregullsitë gjatë zgjedhjeve janë shkaktuar qoftë nga partitë politike apo nga persona apo grupime të lidhura me parti politike.

Gjatë zgjedhjeve ka pasur një mungesë të qartë të llogaridhënies për parregullsitë dhe mashtrimet nga ana e partive politike. Këto ankesa janë vënë në qafë të individëve të caktuar apo grupeve të vogël të personave duke hequr kështu barrën nga shumica e partisë politike. Kjo praktikë duhet të ndryshojë në mënyrë që partitë politike të marrin përgjegjësi për votuesit e tyre duke i shtyrë të edukojnë votuesit për zgjedhje të lira dhe të drejta.

Rekomandimet

1. Amandamentimet e ardhshme të ligjit mbi zgjedhje të përgjithshme dhe lokale duhet të diskutohet me grupe më të mëdha sesa komisionet të caktuara për ndryshimin e ligjit.
2. KQZ duhet të publikojë listën e votuesve të paktën gjashtë muaj para zgjedhjeve në mënyrë që votuesit të jenë në gjendje të ndryshojnë vendvotimet e tyre për të minimizuar votat me kusht si dhe për të deklaruar personat që kanë ndërruar jetë.
3. Ligji për zgjedhje të përgjithshme dhe lokale specifikon që partive politike nuk u lejohet të shpenzojnë më shumë se 0.50 euro për votues të regjistruar gjatë fushatës zgjedhore. Për të imponuar këtë ligj, KQZ duhet të formojë një institucion të pavarur monitorues që do të monitorojë, numërojë dhe llogarisë shpenzimet e partive politike gjatë fushatës zgjedhore. Partitë politike duhet të raportojnë këtij institucioni çdo javë gjatë fushatës zgjedhore.
4. Ligji duhet të ndërrojë në mënyrë që numërimi i votave të bëhet në një qendër të madhe dhe jo në vendvotime përkatëse. Kjo do të zvogëlojë konsiderueshëm numrin e shkeljeve nga anëtarë të komisioneve të politizuara si dhe do ta bëjë procesin e mbikëqyrjes të pavarur të numërimit më të lehtë dhe më të pavarur nga presionet.
5. Metodatat e identifikimit gjatë ditës të zgjedhjeve duhet të përfshijnë skanerë elektronik të shenjave të gishtërinjve. Kjo do të zvogëlonte gabimet e bëra nga personat kontrollues, veçanërisht në rastet e votimit të dyfishtë. Një praktikë e tillë gjithashtu do të zvogëlonte nevojën për masa të sigurisë që mund të jenë problematike, si llambat ultravjollcë dhe ngjyrën e padukshme. Me implementimin e një mase të tillë, do të anashkalohej nevoja për punësimin e dy personave më shumë për qendër të votimit gjë që do ta bënte këtë strategji financiarisht më efektive.
6. Kuvendi i Kosovës duhet të caktojë të paktën 5 euro për votues të regjistruar si buxhet për organizimin e zgjedhjeve. Kjo do të sigurojë një përgatitje më kualitative të zgjedhjeve, një fakt që pritet të influencojë pozitivisht në gjendjen e demokracisë në vend.

6. KQZ duhet të përmbahet nga diskutimi i rezultateve preliminare para përfundimit të të gjitha procedurave ligjore mbi ankesa dhe parashtresa. Gjithashtu, KQZ duhet të ruajë me shumë kujdes informatat e brendshme në mënyrë që të parandalojë rrjedhjen e të dhënave në media.

7. Shoqëria civile duhet të fokusohet në procesin zgjedhor, si dhe sigurimin e pavarësisë dhe mbarëvajtjes së tij në vend se të merret gati ekskluzivisht me rezultatet.